



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**VENDIM**

Nr.306, datë, 19.02.2014

“Për

**hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetare
- Rezana KONOMI Zv/Kryetare
- Servete GRUDA Anëtare
- Koço BROKA Anëtare
- Iva ZAJMI Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 19.02.2014, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Lati(Milo), Znj. Rezana Konomi, Znj. Servete Gruda, Z. Koço Broka, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i ankesës mbi prokurimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës .

**Baza ligjore:** Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi disa shqetësime në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun Dibrës,

**VËREN SE:**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një shqetësim nëpërmjet të cilit pretendohet se në procedurat e prokurimit të realizuara në Qarkun e Dibrës, disa shoqëri të ruajtjes dhe sigurisë fizike kanë marrëveshje në oferta dhe bashkëpunojnë në procedurat e prokurimit në këtë qark. Këto ndërmarrje të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në Qarkun e Dibrës, që prej vitit 2011 mund të kenë marrëveshje në oferta në prokurimet publike.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për procedurat e prokurimit në Qarkun Dibër ka shenja të ngjashme të bashkëpunimit midis shoqërive që operojnë në tregun përkatës, siç janë formularët e ofertës së këtyre shoqërive, janë lëshuar nga e njëjta shoqëri sigurimi, në të njëjtën datë dhe me numër serial të njëpasnjëshëm.
3. Gjithashtu nga shqyrtimi i ofertave të paraqitura rezulton se vlerat e ofertave fituese janë shumë afër fondit limit në rreth 99.9 % të tij.
4. Si konkluzion, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet që kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg; si dhe në Udhëzimin “Mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto shenja mund të tregojnë për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet marrëveshjeve në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun Dibrës.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) me propozim të Sekretariatit,

#### **V E N D O S I:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Dibrës për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga Janar 2012 deri në 30 Janar 2014.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 19.05.2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Rezana KONOMI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

( \_\_\_\_\_ )  
**Zv/Kryetar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**